

AFATET

Afati maksimal i kthimit të përgjigjes është 15 ditë sipas nenit 110 të K.Pr.Penale.

Për marrje kopje aktesh afati është në varësi të procedurës së shqyrtimit, gjendjes së procedimit, volumit të akteve që duhen fotokopjuar por gjithsesi jo më vonë se 15 ditë.

Për marrje vërtetimesh për ndjekje penale afati maksimal është një ditë pune.

PROCEDURAT

Kërkesa paraqitet nga vet personi ose mbrojtësi i autorizuar, depozitohet në Zyrën e Protokollit të prokurorisë ku merr një numër të caktuar prototokolli dhe datë regjistrimi dhe më pas i kalon funksionarit të prokurorisë të cilit i drejtohet. Ky funksionar ka për detyrë të trajtojë këtë shkresë dhe të kthejë një përgjigje në lidhje me të

STANDARTET

Në lidhje me kërkesat do të aplikohen rregullat, procedurat dhe afatet e vendosura në K.Pr.Penale dhe ligjin për të drejtën e informimit.